



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Formular Aplikimi për Marrje Licencë

1. TË DHËNAT E SUBJEKTIT APLIKUES

Emri i subjektit (subjekt juridik/person fizik):.....

Emri tregtar:.....

Adresa e Subjektit:.....

.....

Telefon:.....Fax:.....

E-mail:.....Faqja WEB:.....

Të dhënat e personit të licencuar:

Emri:.....Mbiemri:.....

Adresa:.....

Telefon:.....Fax:.....

2. LLOJI I LICENCËS SË KËRKUAR*.

SHËRBIM PROGRAMI AUDIOVIZIV

- Licencë për shërbimin e programit audioviziv. ☐
- Licencë për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve. ☐

ZONA PËR TË CILËN KËRKOHET LICENCA:

- Qarku.....
- Bashkia.....
- Njësia Administrative.....

*Ky formular vlen vetëm për 1 lloj licence. Subjekti duhet të zgjedhë vetëm 1 kuti.

** Aplikanti duhet të përmbushë kriteret sipas Rregullores së miratuar me Vendimin Nr.2 datë: 16.1.2020.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

3. PËRMBAJTJA E DOKUMENTACIONIT TË APLIKIMIT

	<u>Dokumentat e kërkuara</u>	Plotëso nr e faqeve.
Juridike	Emërtimi, vendndodhja e subjektit aplikues.	
	Ekstrakti i thjeshtë dhe historik i QKB-së për të dhënat e subjektit që bën kërkesën, bashkë me emrin dhe firmën e personit, që ka të drejtë ta përfaqësojë atë, kur nuk përfaqësohet direkt nga përfaqësuesi ligjor, lëshuar jo më vonë se 40 ditë nga paraqitja e aplikimit.	
	Në rastin kur njëri nga ortakët e subjektit aplikues është person juridik duhet të paraqesë Ekstraktin për të dhënat e tij dhe listën e ortakëve të tij.	
	Deklaratë noteriale të secilit prej aksionarëve të subjektit aplikues, lidhur me aksionet/kuotat e zotëruara prej tyre në shoqëri të tjera me veprimtari audio ose audiovizive, dhe në rast se aksionari/ortaku i subjektit është person juridik, kjo deklaratë noteriale nënshkruhet nga përfaqësuesi ligjor i subjektit aksionar/ortak i shoqërisë.	
	Vërtetim i gjendjes gjyqësore të aksionarëve/ortakëve të subjektit.	
	Deklaratën për vërtetësinë e të dhënave të paraqitura.	
	Shenja dalluese identifikuese (logo).	
Mbikqyrje	Depozitimi i kontratave ose marrëveshjeve paraprake me mbajtësit e të drejtave të përmbajtjes që do të transmetohen dhe ritransmetohen.	
	Adresa e detajuar e ambientit (studios) ku janë të instaluar pajisjet audiovizive transmetuese, e shoqëruar me kopje të noterizuar të dokumentit të pronësisë ose nëse nuk është në pronësi të aplikuesit kontratë përdorimi, qeraje etj. Në rast se subjekti ka më shumë se një ambient (studio), adresat e detajuara të secilës prej tyre.	
Ekonomike	Konfirmimi i kryerjes së pagesës për përpunimin administrativ të aplikimit.	
	Dokumentat zyrtare mbi masën e Kapitalit Financiar, neni 7 i rregullores (jo më pak se 3,500,000 lekë)	
	Dokumentacioni mbi planin ekonomiko- financiar për periudhën e vlefshmërisë së licencës.	
	Subjekti aplikues për licencë për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv duhet të paraqesë garanci bankare në masën e pagesës vjetore të miratuar nga AMA për këtë licencë. Shuma e vendosur si garanci do të mbetet e ngurtësuar për një periudhë 9 muaj duke filluar nga data e depozitimit të aplikimit.	
	Çertifikatën e regjistrimit në organet tatimore.	
Program	Karakterin e përgjithshëm ose të tematizuar të shërbimit që ofron.	
	Të dhëna për përmbajtjen e programeve të cilat shprehin qartë në tërësinë e tyre kërkesat për zbatimin e primeve themelore të veprimtarisë audiovizive, si dhe pluralizmin dhe paanësinë e informacionit.	
	Përshkrim i përmbajtjes së emisioneve dhe rubrikave kryesore.	
	Të dhënat statistikore për llojet e programeve që parashikon të transmetojë.	
	Programi javor që parashikon të transmetojë.	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

	Orë transmetimi në ditë, raportin e kohës së transmetimit që do të zënë programet.	
T e k n i k e	Projektin e studios së prodhimit, shoqëruar me bllok-skema funksionale të organizimit të studios dhe të kalimit të sinjalit në fazat kryesore të prodhimit dhe përpunimit, si dhe me përshkrimin e kushteve bazë teknike të mjedisit të prodhimit, përfshirë masat e izolimit akustik dhe ndriçimin profesional.	
	Listën e pajisjeve teknike që do të përdoren për ofrimin e shërbimit, duke përfshirë tipin, modelin, prodhuesin, parametrat teknikë, vendndodhjen dhe dokumentet e përputhshmërisë (CE, EMC, RoHS).	
	Përshkrimin e standardeve të sinjalit audio dhe audioviziv për prodhimin dhe transmetimin, duke përfshirë formatet (SD/HD/UHD), kodekët, frame rate, profilin e kompresimit dhe kërkesat për cilësinë e audios sipas standardit EBU R128.	
	Përshkrim mbi sistemet software që do të përdoren për ofrimin e shërbimit (nëse do të përdoren).	
	Përshkrimin e masave bazë teknike dhe organizative për mbrojtjen e sistemeve dhe përmbajtjes audiovizive, përfshirë, sipas rastit, kontrollin e aksesit, mbrojtjen bazë të rrjetit, enkriptimin e sinjalit kur është teknikisht i aplikueshëm, mekanizma për mbrojtjen e përmbajtjes (si DRM ose ëatermarking) dhe procedurat për kopjimin rezervë dhe rikuperimin e të dhënave.	
	Përshkrimin e sistemit të monitorimit teknik të funksionimit të sinjalit, duke përfshirë mjetet ose pajisjet e përdorura për monitorim të vazhdueshëm, dokumentimin e parametrave kryesorë teknikë dhe mënyrën e ruajtjes së të dhënave të monitorimit.	
	Përshkrimin e mënyrës së dërgimit të sinjalit te operatori i rrjetit, duke specifikuar llojin e lidhjes (fibër optike, IP, SRT, RIST, mikrovalë), protokollet e transportit, garancitë e stabilitetit dhe nivelin e latencës së pranueshme.	
Organizative	Planin e masave për vazhdimësinë teknike të transmetimit, duke përfshirë pajisjet rezervë dhe zgjidhjet e arsyeshme për minimizimin e ndërprerjeve, të përshtatura me përmasën dhe strukturën e aktivitetit të subjektit.	
	Organizimi dhe drejtimi i shoqërisë, anëtarët e Bordit Drejtues (minimumi 9 anëtarë).	
	Curriculum Vitae (CV) përkatëse të çdo anëtari.	
	Të dhëna të paraqitura në formën e një deklarate mbi numrin e punonjësve që parashikon të punësojë me kohë të plotë (jo më i vogël se 10 (dhjetë))	
	Nëse subjekti aplikues ushtron aktivitet audioviziv, vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe/ose Drejtoria e Tatimeve mbi numrin e punonjësve të siguruar të aplikuesit si dhe listëpagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të subjektit për 12 muajt e fundit nga paraqitja e aplikimit.	
	Nëse shërbimi ofrohet nga palë të treta, aplikuesi duhet të paraqesë kontratat e punës të nënshkruara me këto subjekte.	
	Personi i kontaktit, si dhe të dhënat e tij (numër telefoni, adresë email-i, etj).	



NIPT:

[illegible]

Person fizik/Ortakë/Aksionerë:

[illegible]



5. SHTOJCA SQARUESE

- *Ekstrakti i thjeshtë dhe historik për të dhënat e subjektit lëshuar nga Qendra Kombëtare të Biznesit(QKB) duhet të jetë lëshuar jo më vonë se 40 ditë nga paraqitja e aplikimit*
- *Certifikata e Konfirmimit të Njoftimit lëshuar nga AKEP duhet të jetë original ose kopje e noterizuar.*
- *Marrëveshja paraprake me mbajtësin e licencës për transmetime numerike lokale/rajonale ose me Radiotelevizionin Shqiptar, në rrjetin e të cilit do të mbështetet shërbimi i programit audioviziv, duhet të jetë origjinal ose kopje e noterizuar.*
- *Licenca e transmetimit audio dhe audioviziv nuk i jepet subjektit që i është hequr ose i është bërë e pavlefshme licenca me vendim të AMA-s, nëse nuk ka kaluar të paktën një periudhë 10 vjeçare nga data kur i është hequr licenca e transmetimit (neni 6). Pika 2 e këtij neni zbatohet edhe ndaj subjekteve juridikë, aksionarë/ortakë të të cilëve janë individë që kanë qenë, ose janë aksionarë/ortakë në subjekte të cilëve:*
 - a. iu është hequr licenca ose autorizimi me vendim të AMA-s,*
 - b. licenca ose autorizimi iu është bërë e pavlefshme për shkak të ligjit;*
 - c. AMA ka nisur procedurën për heqjen e licencës ose autorizimit;*
 - d. kanë detyrime financiare të pashlyera ndaj AMA-s.*
 - e. Kanë sanksione me gjobë me vendim të formës së prerë dhe nuk i kanë shlyer.**Licenca e shërbimit të programit audioviziv nuk u jepet personave të dënuar për një vepër penale, nëse nuk kanë kaluar 5 vjet nga përfundimi i këtij dënimi.*
- *Pagesa për përpunimin administrativ duhet të kryhet përpara depozitimit të dosjes për aplikim, ose brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit për këtë detyrim nga AMA, në të kundërt aplikimi do arkivohet pa u shqyrtuar.*
- *Dokumentacioni mbi kapitalin financiar duhet të jetë origjinal i firmosur dhe vulosur nga eksperti kontabël dhe nga administrator i shoqërisë/personi fizik. Gjithashtu vlerësimi i masës së kapitalit nuk duhet të jetë më vonë se 6 muaj nga moment i depozitimit të aplikimit.*
- *Plani ekonomik financiar duhet të jetë në formë tabelare, me treguesit e kërkuar sipas zërave respektiv. Dokumentacioni duhet të jetë original dhe i sigluar nga administrator i shoqërisë/ personi fizik dhe i vulosur.*
- *Garancia bankare është dokument i lëshuar nga bankat e nivelit të dytë, ku vërtetohet se aplikuesi ka bllokuar pranë kësaj banke shumën e kërkuar në favor të AMA-s, për një periudhë 9 – mujore nga moment i paraqitjes së aplikimit të tij. Gjithashtu ky dokument duhet të përmbajë kushtet e përcaktuara në rregulloren e AMA- për dhënien e licencës, lidhur me rastet kur kjo shumë mund të ç’ngurtësohet. Dokumenti duhet të jetë origjinal i firmosur dhe vulosur nga përfaqësuesi i bankës që lëshon dokumentin e kërkuar.*
- *Kodi NIPT duhet të jetë original ose kopje e noterizuar.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

6. DEKLARATA

Unë i/e nënshkruari/a

deklaroj se informacioni që kam dhënë është i saktë dhe i plotësuar sipas kriterëve të përcaktuara nga AMA dhe në përputhje me Rregulloren Nr.2 datë 16.1.2020.

Përfaqësuesi Ligjor:

.....

Emër Mbiemër Nënshkrimi

Pozicioni

Personi i Autorizuar:

.....

Emër Mbiemër Nënshkrimi

Pozicioni

Data: . .